



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. 7 Prot.

Tiranë, më 12.11.2019

**PROCESVERBAL**

**Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 12 nëntor 2019, ora 15:30, pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri nisi mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).

Të pranishëm janë:

**Për anëtarët përfaqësues të institucioneve publike:**

1. Znj. Ogerta Manastirliu – *Kryetare e KKShC-së*
2. Znj. Merita Xhafaj
3. Z. Gentian Deva
4. Z. Bekim Murati
5. Znj. Oriana Arapi
6. Z. Redinald Papa
7. Znj. Dajna Sorensen

**Për anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të Këshillit:**

1. Z. Blendi Dibra – *Zëvendëskryetar i KKShC-së*
2. Z. Luan Ahmetaj
3. Znj. Fabiola Laço – Egro
4. Z. Vladimir Thanó
5. Znj. Arta Dymishi
6. Znj. Zana Vokopola
7. Z. Ali Coka
8. Znj. Liliana Dango
9. Z. Indrit Seferi
10. Znj. Afërdita Seiti

**Përfaqësues nga AMShC:**

1. Z. Andi Kananaj – *Drejtor Ekzekutiv*
2. Z. Erion Banushi
3. Znj. Ina Gjini
4. Znj. Paula Bero
5. Znj. Adela Kuçi
6. Znj. Mimoza Çorbaxhi
7. Z. Andi Luga

Mbledhja drejtohet nga Kryetarja e KKShC-së, Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu. Pas verifikimit dhe konfirmimit të kuorumit të nevojshëm për të filluar mbledhjen e Këshillit, znj. Manastirliu falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, i uroi mirëserdhjen anëtarëve të rinj nga shoqëria civile në Këshill si dhe prezantoi e rendin e ditës:

- Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, të mbajtur më datë 22.6.2018
- Ndarja e detyrimeve, ecuria e KKShC-së në vazhdim dhe angazhimi i saj në monitorimin e VKM- së Nr. 539, datë 25.7.2019;
  - Historiku i KKShC-së
  - Roli i KKShC- së në zbatim të Udhërrëfyesit
- Përfshirja e Shoqërisë Civile në Procesin e Negociatave
- Organizimi i Konferencës së parë Kombëtare për Shoqërinë Civile
- Ngritja e Grupit të Punës lidhur me Vullnetarizmin (përcaktimi i afateve; konsultimet etj)
- Të tjera

Znj. Ogerta Manastirliu: “Jam e kënaqur që kemi miratuar dhe kemi në letër Udhërrëfyesin, këtë instrument shumë të rëndësishëm për shoqërinë civile. Ky instrument ngarkon me përgjegjësi Qeverinë, AMShC-në, strukturat në varësi, por më shumë aktivizon shoqërinë civile në zbatim të Planit të masave që Udhërrëfyesi ka përcaktuar. Falënderoj partnerët që kanë kontribuar në këtë Udhërrëfyes, gjithashtu është e rëndësishme të flasim në mbledhjen e sotme për hapat konkrete që duhen ndërrmarë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka lancuar gjithashtu këtë vit dy instrumenta shumë të rëndësishëm si: *Fondi Social* dhe *Ndërrmarja Sociale*.

Sipas agjendës së mbledhjes, pika e parë: Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së fundit të Këshillit.”

Kryetarja e Këshillit ftoi anëtarët e pranishëm për të votuar, të cilët e miratuan unanimisht.

Më tej, znj. Manastirliu vijoi me pikën e dytë të rendit të ditës “Ndarja e detyrimeve, ecuria e KKShC-së në vazhdim dhe angazhimi i saj në monitorimin e VKM- së Nr. 539, datë 25.7.2019” dhe i kaloi fjalën z. Kananaj.

Z. Andi Kananaj: “Doja të bëja një përmbledhje të asaj që është bërë këtë vit, duke qenë se në këtë vit zgjodhëm një strategji duke u bërë si të padukshëm, duke tentuar të ishim më efektiv, dhe në fakt jam i gëzuar të them se kemi një Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përmbledh të gjithë strategjinë lidhur me nevojat e shoqërisë civile dhe përgjatë katër viteve në vazhdim. Dokumenti ka tre strategji shumë të qarta:

1. Bashkëpunimi i institucionalizuar Qeveri – Shoqëri Civile

2. Mjedisi ligjor, mundësimi dhe menaxhimi i përshtatshëm i të dhënave
3. Kuadri mundësues fiskal dhe financues.

Puna jonë ka konsistuar, bashkë me ekspertet e Bashkmit Evropian në realizimin e Udhërrëfyesit, një punë që ka zgjatur për gati një vit duke bërë konsultime me ekspertë të minstrive, me grupe individuale të shoqërinë civile dhe me donatorë në disa qytete si: Korçë, Vlorë, Shkodër, Tiranë.

Udhërrëfyesi ka nëntë prioritete, të cilat kanë 42 masa dhe për secilën nga këto 130 tregues. Në korrik të këtij viti kemi arritur të kemi një proces shumë të plotë lidhur me sa u tha më sipër.

Gjithashtu kemi bërë një proces goxha të vështirë, i cili ka kaluar në disa faza paragjykimesh e mosbesimi e paranojash lidhur me zgjedhjen e katër anëtarëve të rinj të KKShC-së. Fatmirësisht nga këto zgjedhje ka pasur vetëm një ankesë zyrtare.

Ky proces ka pasur dy struktura menaxhuese:

1. Një pjesë nga ana teknike është menaxhuar nga stafi teknik i AMShC-së
2. Kurse nga KKShC-ja ishte z. Blendi Dibra, Znj. Zana Vokopola dhe Z. Vladimir Thanu të përzgjedhur nga Këshilli.

Ky proces ka pasur 428 votues, të cilët zgjodhën katër anëtarët. Ky ka qënë volumi i punës dhe sot jemi gati të vazhdojmë me masat e përcaktuara dhe të miratuara në Udhërrëfyes.

Z. Blendi Dibra: “Roli i KKShC-së është i përcaktuar në ligjin për KKShC-në, funksionet kryesore të së cilit janë konsultimi mes sektorit dhe këshillimi ndaj autoriteteve dhe në mënyrë të veçantë ndaj Këshillit të Ministrave.

Duhet theksuar se ne vazhdojmë të kemi problem me organizmin, ku jemi të detyruar të kemi në bazë të ligjit të paktën tre mbledhje zyrtare; njëkohësisht është detyrim ligjor i autoriteteve publike të cilët duhet të japin informacion lidhur me financimet e sektorit. Ne kemi dërguar dhe kërkesë zyrtare lidhur me këtë çështje.

Në këtë kontekst përballë një arritje shumë të madhe siç është miratimi i Udhërrëfyesit për zhvillimin e shoqërisë civile, vlen të theksohet se Këshillin duhet ta bëjmë më funksional dhe nga autoritetet publike duhet të ketë një vullnet më të mirë për të futur në grupe sektoriale pune ose edhe për të na dhënë informacion, në mënyrë që ky infomacion të shpërndahet në sektor. Edhe në raportin e BE konstatohen mangësi në procesin e konsultimit me shoqërinë civile, i cili nuk zhvillohet në mënyrë efektive.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Jam dakort për ngritjen e grupeve sektoriale më të strukturuar për të diskutuar sa më sipër tha Zv/Kryetari, në mënyrë që incativat të mos ngelen vetëm në letër, por të kemi një punë sa më të gërshetuar dhe të integruar.

Edhe ne si institucione publike kemi nevojë më shumë për t’u njohur me punën e organizatave, me fondet që këto organizata përthithin, komunitet në të cilat ato veprojnë, në mënyrë që gjithë organizimi i ndërhyrjes të jetë i integruar të mos jetë i segmentuar, i fragmentarizuar, kjo në funksion të një mbulimi më të mirë me ekspertizë, me asistencë, me

shërbime dhe të gjithë ato elemente që vetëm sëbashku mund t'i sigurojmë. E them këtë sepse nga të dyja palët duhet të ketë informacion. Dhe pikërisht Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile këtë rol ka, të ndërtojë një partneritet, i cili të mos jetë vetëm një strukturë që mbledhet për shfaqje rutinë, por të marrë informacion si nga institucionet qeveritare dhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe t'i ndajmë këtu së bashku për të pasur gërshtimin e informacionit dhe për të nxjerrë dhe demonstruar këtë vullnet që në fakt ne të gjithë e demonstrojmë duke e thënë, por pastaj kur vjen momenti për të nxjerrë rekomandime të vlefshme ato mbeten vetëm në letër.”.

Më tej u vijua me pikën tjetër të rendit të ditës lidhur me përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave.

Z. Redinald Papa – *përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*: “Për sa i përket hapjes së negociatave, ka filluar procesi *screening* që në shtator 2018 kur ka filluar dhe kapitulli 23. Ka vazhduar puna përsa i përket harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Përfshirja e shoqërisë civile është bërë me anë të takimeve të grupeve të punës, të cilat kanë një rol të rëndësishëm për procesin e integritimit evropian. Pas procesit *screening*, vazhdon procesi ku Qeveria Shqipëtare në mënyrë të detajuar do të vazhdojë me kapitujt negocues për integrimin evropian.

Ndërkohë vazhdon Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), ku përfshihet dhe shoqëria civile me ndihmën e saj për një process sa më efikas dhe mbarëvajtjen e PKIE. Shoqëria civile është e ftuar të marr pjesë në takime dhe diskutimet për të gjitha proceset që u thanë më lart. Jemi në vazhdimësi të takimeve përsa i përket edhe fondeve IPA.”.

Znj. Ogerta Manastirliu: “Në takimet e rradhës është e rëndësishme që shoqëria civile të na thotë konkretisht ku është angazhuar, cilat janë grupet që ajo ka reflektuar të gjitha këto komente, sugjerime apo reflektime në të gjitha proceset për integrimin evropian, dhe duke pasur këtë informacion mund të na e thoni edhe paraprakisht nëpërmjet email-it.”.

Z. Redinald Papa: “Çdo kapitull ka një grup pune të caktuar.”.

Më pas u kalua në pikën tjetër mbi organizimin e Konferencës së parë Kombëtare për Shoqërinë Civile.

Z. Andi Kananaj: “Do të doja paraprakisht të thoja se më është kërkuar nga National Resource Center që të prezantoj një kërkesë të tyre për realizimin e një konference të përbashkët dhe për këtë do të doja edhe mendimin tuaj. Apo do të vendosim të bëjmë dy konferenca të ndara?”.

Znj. Ogerta Manastirliu: “Është një çështje që duhet diskutuar dhe votuar – është koha e duhur apo kur mund të bëhet Konferenca e parë Kombëtare dhe si mund të organizohet.”

Z. Blendi Dibra: “Që vitin e shkuar kemi patur në plan të realizojmë këtë konferencë, por për arsye logjistike nuk është bërë. Ndërkohë nga Partners Albania dhe National Resource Center është qëllim për organizimin e një konference të tillë.

Personalisht mendoj se National Resource Center i ka potencialet për organizimin nga ana logjistike të një konference si ajo që ne kërkojmë dhe mendoj se është momenti i përshtatshëm për ta bërë, por është shumë i rëndësishëm mendimi dhe dakordësia juaj.

Unë sugjeroj të ngremë një grup pune së bashku me Partners Albania për të përcaktuar hapat e mëtejshëm.”.

Znj. Zana Vokopola: “Kam një problem, sepse ata persona që më kanë votuar në Këshill për përfaqësinë time më bëjnë vazhdimisht pyetje: *Në këto vite çfarë keni arritur? Çfare keni bërë? Na tregoni një sukses.*

Unë e gjej të vështirë t’i përgjigjem, kështu që kur ne të shkojmë në konferencë do më duhet të kemi një matërial të ndarë. Në qoftë se unë shkoj në një konferencë për të dëgjuar edhe njëherë problemet që i kemi degjuar në shumë tavolina, ne nuk kemi asnjë vlerë të shtuar në këtë konferencë. Kur më pyesin në lidhje me llogaridhënien, i them se kemi çuar ca letra por nuk kemi marrë kurrë përgjigje. Kur flasim për bashkëpunim dhe komunikim me Qeverinë, kujtohem që s’marr kurrë përgjigje nga Qeveria. Teorikisht procesi komunikimit duhet të vijë nga lart poshtë, nuk shkoj unë t’i kap ministrat, janë ministrat që po patën ndonjëherë dëshirë na takojnë.

Në këtë situatë mendoj a jemi në kohën e duhur për të bërë një konferencë?

Mendoj më parë duhet të bëjmë dy tre gjëra, të kemi disa arritje pastaj të bëhët konferenca.”.

Z. Vladimir Thano: “Falenderoj Zanën për ato që tha, po në të njëjtën kohë dua të them që kontraparti jonë është bashkëpunuese. Me zemër do të doshiroja që hosti i konferences së parë të vijë nga zonja kryetare dhe zoti zv/kryetar. Dhe këtu kam një vërejtje për Zv/Kryetarin e KKShC-së, sepse kur diskutonim disa gjëra dhe viheshim në pozita të vështira, nuk mund të kategorizohem se kemi një konflikt të brëndshëm dhe një diskutim linear; këto janë gjëra që ripërsëriten dhe vijnë nga aktorë të jashtëm; të shihen mesazhet elektronike (e-mail) për të kuptuar. Kjo është një vërejtje që e kam me linjën e komunikimit në KKShC.

Nga ana tjetër jam dakort që si National Resource Center, por edhe Partners (faktor i rëndësishëm që ka shtyrë procese të rëndësishme në Shqipëri), që të jënë partnerë të konferencës. Por nga ana tjetër dua të theksoj se KKShC funksionon në bazë të legjisllacionit përkatës dhe që ne të kemi partnership me çdo organizatë ka një mënyrë komunikimi për të cilën natyrisht duhet votuar nga Këshilli, dhe në qoftë se ne nuk e kemi një gjë të tillë duhet ta ngremë.

Gjithashtu desha të kujtoja disa gjëra specifike që lidhen me nenin 7, ku thuhet se KKShC-ja duhet të miratojnë jo më vonë se data 30 janar Raportin Vjetor. A ka një të tillë? Këshilli raporton të paktën një herë në vit pranë Këshillit të Ministrave osa sa herë që kërkohet nga shoqëria civile. A ka AMShC-ja kapacitete për të garantuar mirëmbajtjen e një konference vjetore? Legjisllacioni gjithashtu parashikon që Këshilli mund të ngrejë një ekip ekspertësh që të rishikojë të gjithë problematikën e brendshme që ka dalë nga Udhërrëfyesi.

Edhe sigurimi i fondeve për KKShC është një adresim që ka dalë nga Udhërrëfyeni dhe i drejtohet AMShC-së. Duhet të ketë një bashkëpunim më të fortë midis Kryetarit dhe Zv/Kryetarit, sepse ne mbledhemi vetëm te Zëvendëskryetari. Nuk mund të shkojmë në një konferencë demotivuese, jo duhet të shkojmë në një konferencë realiste. Kohën mund ta diskutojmë. Por kryetari duhet të merret me ftesat dhe anën formale të organizimit të saj.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Vlerësoj fjalën e Ladit dhe Zanës. Pikat e ngritura janë konkrete dhe realiste. Me miratimin dhe vendimin unanimit të Këshillit do organizohet konferenca, e cila duhet të jetë realiste dhe jo demotivuese, edhe sfidat edhe problematikat duhen çuar në konferencë. Hapat konkretë dhe shumë pozitiv janë bërë. Gjithashtu edhe problematikat mund të adresohen në konferencë. Kjo është një praktikë që do të iniciohet nga kryetarja dhe e cila do të vazhdojë të organizohet periodikisht.

Do të ketë të ftuar dhe pjesëmarrës që janë modele suksesi. Kjo konferencë sigurisht do të jetë sipërmarrja jonë. Për çështjen e kontaktit, gjithashtu kemi mbajtur takime ndoshta edhe jo shumë frekvente, por kemi adresuar çështjet më të rëndësishme. Unë e kuptoj që shoqëria civile do të jetë më afër qeverisë në funksion të problematikave që dalin në punën tuaj.

Jam dakord të bëhet vlerësim, ndoshta në mbledhjen e ardhshme, përse i përket ndryshimit të ligjit. Jam dakord gjithashtu të krijohet një grup më i vogël për organizimin e konferencës. Raporti i parë duhet të bëhet brenda datës 30 janar. Ky raport do të ketë evidencën çfarë është bërë dhe çfarë jo, dhe pas miratimit të tij në Këshill të marrim një vendim për konferencën. Raporti do të na tregojë edhe a do jemi gati apo jo të vazhdojmë me konferencën.”

Z. Ali Coka: “Eskluzivitetin për organizimin e një konference kombëtare nuk duhet ta ketë Partners Albania (që ka thithur gjithë fondet e BE), por Ogerta Manastirliu.

Falenderoj organizatat që më kanë mbështetur. Me mua nuk do takoheni më, se me mbaron mandati.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Faleminderit për kontributin që keni dhënë gjatë këtyre viteve, edhe pse do t’ju mbarojë mandati nuk do të thotë që ju nuk do të jeni pjesë e të ftuarve në këtë Këshill, ne do vazhdojmë ta duam kontributin tuaj edhe në vazhdim.

Propozoj të hedhim në votë për mënyrën e propozuar edhe nga ju për vlerësimin e konferencës së parë pas miratimit të raportit të dtës 30 janar. Të gjithë dakort. U miratua.

Më pas u kalua te pika tjetër e rendit të ditës mbi vullnetarizmin.

Znj. Merita Xhafaj: “Në Planin e masave të Udhërrëfyesit është edhe vullnetarizmi, paketa e akteve nënligjore është, por nuk është formatuar akoma dhe kjo çështje i është lënë KKShC-së përgjegjësia për rishikim dhe hartimin e kësaj pakete. Ligji për vullnetarizmin ka nevojë të pasurohet dhe të rishikohet në ato pjesë ku bën të pamundur frymën e vullnetarizmit dhe gjithashtu zbatimin e tij. Prandaj krahas paketës së akteve ligjore, KKShC-së i lind e drejta për të rishikuar ligjin.”

Znj. Dajna Sorensen: “Të gjitha aktet nënligjore të parashikuara për vullnetarizmin janë miratuar të gjitha. Tre akte janë, të treja të miratuara.”

Znj. Merita Xhafaj: “Në të gjithë hartimin e Udhërrëfyesit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka patur përfaqësuesin e vet, por realisht organizatat e shoqërisë civile dhe KKShC kanë parë të arsyeshme që ky ligj ka disa barriera dhe bëhet i pazbatueshëm sidomos për vullnetarët që aktivizohen nga shoqatat e shoqërisë civile.”

Z. Vladimir Thano: “Në kohën kur ekspertiza që u mor me çuarjen përpara të Udhërrëfyesit, që sot e kemi të miratuar me VKM hasi problematika dhe ishte një nga problematikat pjesë e Udhërrëfyesit të vjetër; u ripozicionua edhe një herë për ta riparë legjislacionin në fuqi. Unë personalisht nuk e di deri ku ka shkuar, por jam i gatshëm që në emër të Këshillit të jem pjesë e këtij grupi, në qoftë se do të ketë një të tillë.

Pesë nga prioritetet që kemi futur në Udhërrëfyes mendoj herë pas here duhet t’i fusim në agjendat e mbledhjeve të Këshillit.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Jam dakort të ngrihet një grup i vogël për rishikimin e paketës së akteve dhe nëse ka nevojë për ndryshim. Kjo ishte pika e fundit e rendit të ditës, kush ka komente mund të marrë fjalën.”

Z. Luan Ahmetaj: “A jemi ne vërtet zëri i shoqërisë civile shtrirë në mënyrë vertikale apo horizontale? Jemi ne pjesë e vendimmarrjes për të qenë me të vërtetë në avangard të shoqërisë civile?

Kjo do të matej vërtetë sesa ne jemi të përfshirë në çdo ministri përkatëse. Këtu nuk u tha për shembull se është miratuar buxheti për vitin 2020, dhe ne nuk e dimë se sa shoqëria civile ka pjesë?

Gjithashtu, temë tjetër është e lidhur me transparencën. Ne jemi mbledhur këtu sot, por si do të shkojë zëri ynë jashtë kësaj mbledhje? Mendoj se duhet të marrë pjesë edhe media që të përçojnë në çdo familje shqiptare edhe te organizmat ndërkombëtarë zërin tonë, ose të jepet një konferencë për shtyp ose një komunikatë për shtyp.

Një çështje tjetër është vendimmarrja, ne duhet të bëhemi pjesë e vendimmarrjes jo vetëm të propozojmë çështje. A ka marrë pjesë ndonjë nga ju në mbledhjet e Komisioneve Parlamentare?

Gjithashtu çështje tjetër është, si na vlerëson ne anëtarësia?”

Znj. Fabiola Laço – Egro: “Unë jam aktiviste e të drejtave të njeriut dhe grave për më shumë se 20 vite dhe kam punuar fort. Duke qenë pjesë e Këshillit do të jap një dorë që shoqëria civile të ndihet më shumë. Shoh që ka shumë sfida, por nga ana tjetër kemi dhe një arritje në dorë që është Udhërrëfyesi, i cili ka edhe një plan masash dhe 130 tregues që duhen arritur. Jemi përballë organizimit të një konference, e cila duhet të organizohet çdo vit. Nuk është organizuar, do organizohet tani. Kjo është një sfida e madhe. Jam shumë dakort që konferenca të shtyhet jo vetëm pas Janarit, pas raportit, por edhe më pas duke ngritur një komision i cili do përgatisë e do mbledhë të gjithë dhe do monitorojë të gjitha sfidat që u thanë dhe çfarë do bëhet.

Nga ana tjetër duhet të bëhemi me dije edhe për buxhetin edhe për ligjin e vullnetarizmit; znj. Sorensen tha që paketa e akteve ligjore ka dalë. Një nga gjërat që më vjen tani në mendje për vullnetarët është që çdo organizatë duhet të paguajë për çdo vullnetar sigurimet shoqërore të tyre.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Në orën 17:00 unë duhet të largohem sepse kam një konferencë për shërbimin farmaceutik. Do doja të flisnin të gjithë.”

Z. Vladimir Thanu: “Z. Luan duke qenë se ju nuk keni qenë pjesë e takimeve më të vogla që ne kemi bërë, një nga çështjet që ne kemi adresuar, siç është Komisioneri për të drejtat e njeriut që merret me ankesat e qytetarëve, ne do të dalim me një spot, dhe pa media, ku t’i kërojmë edhe organizatave të shoqërisë civile por edhe organizatave më të mëdha që të marrim sugjerime reale ose urgjente. Dua gjithashtu të falenderoj AMShC-në për punën e bërë.”

Znj. Dajna Sorensen: “Dy sqarime të shpejta për ligjin për vullnetarët. Tre aktet ligjore janë miratuar në maj – qeshor të këtij viti, për kodin e etikës vullnetare, dhe dy urdhra ministri për regjistrin e vullnetarëve dhe për librezën e vullnetarëve. Të treja këto akte janë të miratuara. Gjithashtu për t’i kthyer një përgjigje znj. Egro, për pjesën e sigurimit të vullnetarëve, flasim vetëm për sigurim shëndetësor ndaj aksidenteve që mund të ndodhin, i cili është vetëm 60 lekë/muaj, një vleftë qesharake 0.03% e pagës minimale. Nuk po flasim për sigurime shoqërore, por shëndetësore të cilat mbrojnë vullnetarët në rast aksidenti.”

Znj. Ogerta Manastirliu: “Shumë faleminderit për sqarimin, se ndonjëherë çështja e sigurimeve amplifikohet. Puna e vullnetarit duhet të ketë patjetër sigurime shëndetësore duke e bërë punën e tyre më të besueshme në tërësi.”

Znj. Zana Vokopola: “Ne kemi dy role si shoqëri civile, vijmë si ekspertë por edhe si aktivistë. Pa të dhëna, pa numra, pa shifra të dy palët bëjmë gabime. Por numrat nuk i siguroj dot vetë unë, numrat në të dyja rastet si aktivist, si ekspert m’i siguron qeveria. Për këtë arsye gjithmonë e më shumë do na duhet t’ju referohemi juve për shifra.”

Z. Indrit Seferi: “Përfaqësoj të rinjtë dhe fushën e shëndetit si ekspert. Ajo që kam evidentuar në takime të herëpashershme me anëtarë të shoqërisë civile, është fakti i përmirësimit të komunikimit mes njëri tjetrit në KKShC, por edhe me organizatat e tjera që ne përfaqësojme këtu. Ne kemi propozuar një adresë kontakti (AMShC-ja mund ta realizojë), ku shqetësime apo ankesa apo problematika të adresohen, pasi është e pamundur që ne të kemi kontakt me të gjitha organizatat. Kjo është një formë e duhur që duhet marrë në konsideratë. Nga ana tjetër ka të bëjë me vizibilitetin e punës që bën KKShC-ja, sepse duhet parë puna që bëhet këtu edhe nga anëtarët e tjerë të shoqërisë civile që nuk kanë kontakt të drejtpërdrejt me anëtarët e Këshillit.

Konferenca mund të jetë një mënyrë e mirë për të treguar se cilat janë vështirësitë, sfidat. Çfarë është bërë dhe çfarë do të bëjmë dhe cilat janë masat që duhet të ndërmarim, pavarisht situatës. Edhe një spot do të ishte një element i mirë.”



Znj. Afërdita Seiti: “Çështja e vizibilitetit është problematikë e diskutuar që më herët në Këshill. Dhe është vendosur që do të jetë AMShC-ja që ka hapur në faqen e saj një link që çdo informacion do të publikohet. Ne si Këshill kemi pasur edhe arritje, kemi ngritur infrastrukturën ligjore, dhe rishikimi i Udhërrefyesit ka qënë një sfidë e jona, kemi qënë ne që jemi mbledhur shumë herë vullnetarisht. Por ana e vizibilitetit mendoj se çalon, dhe mendoj se ne duhet të jemi më aktiv. Është mirë që të kemi një sistem që të funksionojë realisht dhe të kemi vizibilitet.

Një çështje tjetër është përsa i përket dy instrumenteve të rëndësishme që Ministria e Mirëqenies Sociale ka, çështja e financimit të shërbimit të personave në nevojë (Fondi Social), dhe ne mendojmë që ky fond social duhet të mbështesë organizatat që kanë standarde, nuk dua të përjashtoj ato shoqata që kanë projekte të bukura, shërbime të mira dhe organizatat e reja, por në radhë të parë duhet të bëhen të qëndrueshme shërbimet që janë në terren. Këtu dua ta lidh diskutimin edhe me pushtetin vendor, i cili nuk i ka marrë parasysh fare këto aspekte.

Nga ana tjetër edhe për buxhetimin që jepen në mënyrë të përgjithshme dhe nuk specifikohen dhe ne nuk dimë ku shkojnë këto para – na thanë se do t’i specifikojnë, por deri më sot nuk na i kanë dërguar. Gjithashtu ne nuk arritëm të organizojmë një konferencë, AMShC-ja të organizojë financimin, sepse nuk ka vendosur fonde dhe nuk na ka mbështetur.”

Z. Andi Kananaj: “Nuk është e vërtetë që AMShC-ja nuk ju ka mbështetur. Ne nuk kemi pasur kërkesë për organizim konference dhe kërkesa duhet të vijë në mënyrë formale. Këtu ka dy keqkuptime shumë të mëdhaja:

1) E para ka të bëjë me mënyrën se si ne duhet t’i trajtojmë mediat?

Ne mdat thjesht mund t’i njoftojmë – media vendos agjendën e vet. Kështu që në qoftë se doni vizibilitet duhet të bëni gjëra interesante për median, nuk ka lidhje, unë kam punuar shumë vite në media dhe e njoh shumë mirë. Jo vetëm këtu, por në të gjithë botën ka një përplasje midis mediave dhe vizibilitetit të OJF-ve.

2) Kurse përsa i përket kërkesës për organizimin e konferencës, ne e kemi fondin për organizimin e këtij eventi, por nuk kemi marrë kërkesë për organizimin e saj. Nuk ka munguar nga AMShC-ja mbështetja.

Edhe diçka tjetër, projekt buxheti është online, mjafton të futesh dhe i merr të dhënat. A kemi ndonjë gjë që na pengon të futemi online në Shqipëri? Jo. Keni nevojë që t’ju zbërthejmë të dhënat? Zbritje, mbledhje...na thoni.”

Z. Bekim Murati: “Sjell zërin në nivel vendor, kështu që edhe pushteti vendor do të ketë një avokat. Për atë çka u diskutua për fondin social unë nuk jam dakort, sepse unë por edhe Ministria jemi shumë të angazhuar që shërbimet sociale të shkojnë më tutje, dhe po ecin. Ndërkohë që kemi marrë një angazhim për aktet ligjore në këtë shërbim. Ne ju kemi ftuar dhe besoj do të vazhdojmë t’ju ftojme edhe në takimet në vazhdim, ka një Këshill Konsultativ që zhvillohet çdo muaj, jemi në mbledhjen e 14-të dhe do të shikoni se sa akte do të sjellë Ministria e Mirëqenies Sociale, lidhur me çështjet sociale, me asistencën sociale, do të shikoni se si po ecen procesi i decentralizimit dhe bazën ligjore. Sigurisht është çështje për

t'u diskutuar, por ne kemi rënë dakort dhe kemi miratuar fondin social, ashtu siç kemi miratuar edhe ndërrmarrjen sociale. Shikoni më mirë në nivelin vendor se çfarë ndodh sepse ka lëvizje të shpejta dhe ka një dinamikë tjtër nga ajo çfarë ju dini deri tani.”

Znj. Afërdita Seiti: “Ju falenderoj. Ndryshimet ligjore unë i di, po flas për fondin social. Prioritet u kanë dhënë organizatave të reja dhe shërbimeve të reja, shërbime të modernizuara. Unë kam katër shoqata dhe kam 20 vjet që jap shërbime të standardizuara.”

Znj. Merita Xhafaj: “Më duket se e ke kuptuar gabim. Fondi Social nuk financon organizatat, financon bashkitë. Janë bashkitë ato që përzgjedhin organizatat.”

Znj. Oriana Arapi: “Për të dhënë një informacion për punën që po kryhet nga ana e Qeverisë Shqiptare për të ndjekur monitorimin e zbatimit të Udhërrfyesit. Kemi filluar organizimin e punës për të marrë informacion nga të gjitha institucionet. Ministrinë e linjës apo struktura të tjera të përfshira në Plan Veprimin e Udhërrfyesit për të marrë një status të situatës se ku jemi, çfarë ka bërë secili institucion dhe çfarë mbetet për t'u bërë në vijim. Ky proces po organizohet nga ne, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe AMShC-në, po koordinojmë mbledhjen e imputeve për sigurimin e të dhënave. Kjo do të kërkojë fonde, besoj në momentet në vijim do të kemi një dokument të pjekur, shpresojmë për janarin, por do të jemi në komunikim për këtë.

Nga ana tjetër ky është një organizim i punës sonë të brendshme dhe një aspekt tjetër që do të kemi një grup ndërinstitucional në nivel teknik për të ndjekur zbatimin e masave për Udhërrfyesin, që do të ngrihet me urdhër të Kryeministrit. Ekziston një grup pune, por do të bëhet një përditësim i tij.

Dhe gjëja tjetër që doja të ndaja me ju është se në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian kemi parë mundësinë për të mobilizuar një asistencë teknike minimalisht 1-vjeçare, që do të na asistojë në masat prioritare të Udhërrfyesit. Kemi filluar një procedurë dhe shpresojmë që do të fillojë në fillim të vitit 2020 dhe do të jetë e orientuar për të asistuar punën e Këshillit dhe të gjithë institucionet që merren me sigurimin e një mjedisi mundësues, gjithashtu asistencë për të siguruar rishikimin e një sërë aktesh, siç u përmend edhe rishikimi i ligjit për KShC-në, dhe akte të tjera ligjore, si dhe fillimin e punës në lidhje me regjistrin për dshoqërinë civile duke parë si nga aspekti ligjor ashtu edhe nga aspekti i infrastrukturës IT. Me ndihmën e Delegacionit shpresojmë që të mbyllet procedurat dhe në fund të muajit janar të kemi ekipin e asistencës që të fillojë punën dhe në momentin më të parë do t'ju informojmë dhe prezantojmë me ekspertët.”

Znj. Merita Xhafaj: “Para dy javësh është bërë një takim rajonal për rishikimin e platformës për veprim, doja t'ju informoja shkurtimisht, sepse në atë konferencë ka qënë e pranishme shoqëria civile. U bë një vlerësim dhe shumë faleminderit UN që ka bërë të mundur pjesëmarrjen e një grupi nga BE, perfaqësues nga strukturat shtetërore, dhe nga Ministria e Jashtme, dhe tre nga shoqëria civile. Falenderoj organizatat e shoqërisë civile, sepse ka qënë i vetmi vend Shqipëria, ku janë ngritur dhe kanë thënë se parlamenti Shqiptar dhe të gjitha ligjet që kalojnë, i konsulton me organizata e shoqërisë civile. Dhe kjo u shpreh dhe ne raportin përfundimtar dhe në konkluzione. Më vjen mirë që vlerësohet ky rast sepse ne

realisht i konsultojmë, natyrisht nuk mund të jenë të gjithë të pranishëm. Të gjitha dokumentat që kemi për t'u miratuar hidhen në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.”

Znj. Zana Vokopola: “Regjistër që nuk funksionon. Kjo ka qënë ankesa kryesore e jona.”

Znj. Merita Xhafaj: “Regjistri funksionon dhe jeni të mirëpritur që të jepni komentet tuaja. Përtej kësaj të gjitha konsultohen dhe është bërë prezent dhe në rakordimin rajonal të organizuar nga UN.”

Znj. Zana Vokopola: “Cilat janë këto organizata që kanë shkuar, se ne nuk i dimë? Se nuk janë konsultuar me ne.”

Znj. Merita Xhafaj: “Përzgjedhja e organiztave që kanë shkuar në këtë takim nuk është bërë nga KKShC-ja, dhe unë nuk kam ardhur të raportoj si janë përzgjedhur organizatat që kanë shkuar në këtë takim, unë kam ardhur të them se tre përfaqesues nga shoqëria civile kanë qënë prezent.

Gjëja e fundit që dua të kërkoj është se në qoftë se duhet të përgatisim një raport që ta kemi me datë 30 Janar, do t'u kërkoja të gjithë përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile, sipas grupeve të organizatave që përfaqësoni të dërgoni në AMShC të gjithë rrjetin e organizatave që ju punoni dhe që janë të financuar nga donatorët ose nga fondet publike. Kjo për arsye se siç kemi detyrë ne të japim llogari kanë detyrë të gjithë këtu të japin llogari dhe kjo vlen nga të dyja anët. Ne do të sjellim informacion për zbatimin e Udhërrfyesit.”

Mbledhja u mbyll në orën 17:30.

**Mbajti procesverbalin:**

Znj. Ina Gjini

**Zv/Kryetar i KKSHC**

Z. Blendi Dibra